



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: ARKEOLOGJIA ROMAKE

Pedagogu: Prof. Asoc. Dr. Belisa MUKA
Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestër: I/II

EKSTRAKT

Kjo lëndë synon që nëpërmjet të dhënave arkeologjike, të trajtojë Romën dhe qytetërimin romak, i cili u zhvillua në ato përmasa sa t'i japë emrin një qytetërimi të tërë dhe të nxjerrë në pah impaktin që pati ky qytetërim – në kuptimin e gjerë të termit – tek shoqëritë, kultura dhe zhvillimi ekonomik i Evropës veri-perëndimore dhe pellgut të Mesdheut. Krijimi i provincave dhe funksionimi administrativ i sistemit Provincial Romak, Romanizimi dhe zhvillimi urban i provincave romake, transformimet, programet monumentale, modelet arkitekturore dhe qarkullimi i ideologjisë perandorake, kultura materiale, etj. janë disa nga çështjet kryesore që do të trajtohen në këtë lëndë. Në përfundim të këtij programi, studenti duhet të jetë në gjendje të njohë, jo vetëm karakteristikat e arkitekturës dhe artit romak, por edhe veçantitë, madhështinë dhe limitet e artit dhe të kulturës materiale në provincat e botës romake, sidhe transformimet në modelet arkitekturore në këto zona. Një pjesë e mirë e orëve mësimore do t'u kushtohen diskutimeve me qëllim që studentët të zhvillojnë qendrimet objektive mbi çështje dhe problematika të caktuara. Leksionet do të shoqërohen nga shumë imazhe, të cilët do të materializojnë teorinë që do të trajtohet nëpër leksione. Kjo formë synon të lehtësojë të kuptuarit e tematikave që trajton programi dhe njëherazi do të stimulojë studentët të diskutojnë dhe të shprehin këndvështrimet e tyre rreth tematikave dhe problematikave që do të trajtohen.

TEMAT:

LEKSION 1. Historia e Romës : shteti dhe qytetërimi romak nga dinastitë etruske tek ato perandorake. Momentet historike më të rëndësishme (Pjesa e parë)

- LEKSION 2.** Historia e Romës : shteti dhe qytetërimi romak nga dinastitë etruske tek ato perandorake. Momentet historike më të rëndësishme (Pjesa e dytë)
- LEKSION 3.** Qyteti i Romës : topografia, zhvillimi i qytetit, transformimet urbane nga Monarkia, tek Republika dhe Perandoria. Monumentet kryesore të arkitekturës së qytetit të Romës
- LEKSION 4.** Provincat romake dhe funksionimi administrativ i sistemit Provincial Romak. Procesi i Romanizimit.
- LEKSION 5.** Qendra monumentale e qytetit romak : Forumi dhe monumentet kryesore në të. Zhvillimi dhe transformimi i Forumit romak nga epoka republikane tek ajo perandorake. Forumet kryesore provinciale, Forumi i Butrintit
- LEKSION 6.** Tempulli romak: arkitektura religjioze në qendrën urbane, rrethinat extra-urbane dhe në provinca. Tempujt indigjenë dhe transformimet e tyre.
- LEKSION 7.** Monumentet e spektaklit : Teatri, Amfiteatri, Odeoni, Cirku dhe Stadiumi. Amfiteatri i Durrësit.
- LEKSION 8.** Monumentet hidrike : Ujësjellësit dhe Termat romake. Termat provinciale dhe Termat në Shqipëri dhe Akuaduktet e Durrësit dhe Butrintit.
- LEKSION 9.** Monumentet e tjera hidrike : Sistemet kanalizuese, Fontanat; Nymfetë dhe Latrinat
- LEKSION 10.** *Domusi* romak dhe *Villa* romake : Tiparet kryesore dhe transformimet gjatë periudhave republikane dhe perandorake; *Domusi* dhe *Villa* në provinca.
- LEKSION 11.** Rrugët dhe mjetet e komunikimit : ndërtimi i rrugëve, infrastruktura, *Tabula Peutigeriana*. *Via Egnatia* dhe rrugë të tjera romake në Shqipëri.
- LEKSION 12.** Bota e përtejme : tipet kryesore të varrimeve, inventarët e varreve, stelat, sarkofagët, etj.
- LEKSION 13.** Arti ornamental, piktura, skulptura, argjendaria dhe numizmatika.
- LEKSION 14.** Kultura materiale : tipologjitë kryesore të enëve (terra sigilatta, kandilët, amforat, etj.), konceptet kryesore të teknologjisë së prodhimit.
- LEKSION 15.** Dardania, Iliria e jugut dhe Epiri në periudhën romake: një vështrim i përgjithshëm.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

10 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (10% e notës përfundimtare)

20 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 8-10 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

30 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 8-10 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit)

LITERATURA:

1. P. GROS, M. TORELLI, *Storia dell'Urbanistica. Il mondo romano*, Roma-Bari, 1988 (veçanërisht faqet 237-426)

2. R. HINGLEY, *Globalizing Roman Culture : Unity, diversity and empire*, London, 2005

3. *Apollonia d'Illyrie 1 : Atlas archéologique et historique*, Athènes, Roma, 2007 (veçanërisht « Les monnaies d'Apollonia », f. 81-106 ; « La sculpture », f. 111-128 ; « Le centre Monumental », f. 186-217 ; « Les domus d'Apollonia », f. 290-300)

4. D.S. ROBERTSON, *A handbook of Greek and Roman Architecture*, Cambridge, 1959 (veçanërisht pjesën për Arkitekturën Romake)

5. I.L. HANSEN, R. HODGES (edt.), *Roman Butrint*, Oxbow, 2007

6. M. HENIG, *A handbook of Roman Art : a Survey of the Visual Arts in the Roman World*, Phaidon, 1983

7. G. BEJOR, M. T. GRASSI, S. MAGGI, F. SLAVAZZI (eds), *Arte e archeologia delle Province Romane*, Milano 2011

8. A. GIULIANO, *La cultura artistica delle province della Grecia in età romana* (Epirus, Macedonia, Achaia : 146-267 d.C.), Roma, 1965